

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NË FUSHËN E ZBATIMIT TË PROGRAMEVE TË MBËSHTETJES PËR BUJQËSINË
DHE ZHVILLIMIN RURAL

NDËRMJET:

MINISTRISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Shqipërisë, referuar më poshtë si “Palët”,

Të udhëhequr nga qëllimi për bashkëpunim midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural i cili është i domosdoshëm për zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale dhe afatgjatë dhe për besimin reciprok ndërmjet palëve kontraktuese dhe qytetarëve të tyre përkatës në veçanti të fermerëve.

Duke pasur parasysh se, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Republikës së Shqipërisë në takimin e përbashkët të dy qeverive, më datë 26.11.2021 në Elbasan, kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit në fushën e bujqësisë,

Me synim dhënien e kontributit pasi Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) e cila ka mandat në krijimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve në fushën e bujqësisë duke përfshirë veterinarinë dhe pylltarinë dhe në kontekst të kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor do të vendosë kornizat e bashkëpunimit teknik me Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, institucion varësie i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vijim “Agjencitë”.

Të bindur se kjo Marrëveshje t’i hapë rrugë një partneriteti strategjik dhe të mundësojë thellimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe përvojave në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Me synimin, nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të mira dhe për të forcuar përpjekjet e vazhdueshme në fushën e interesit të ndërsjellë dhe përgatitjen e sistemit të përgjithshëm të zbatimit për përthithjen dhe përdorimin efikas të fondeve të para-anëtarësimit IPARD, palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë marrëveshjen si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është bashkëpunimi i palëve, brenda fushës së tyre përkatëse të aktiviteteve në lidhje me përafrimin e Politikave me Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) si dhe në kryerjen e aktiviteteve të Agjencive për Zhvillimin e Bujqësisë.

2. Për përfitimin e tyre reciprok, Agjencitë do të bashkëpunojnë, do të shkëmbejnë përvoja, njohuri dhe ekspertë për programin IPARD dhe skemat kombëtare mbështetëse, sipas legjislacionit në fuqi të BE-së dhe legjislacionit përkatës kombëtar të secilës prej palëve, si në vijim:

2.1. AZHBR do të mbështesë AZHB në përgatitjet për paketën e akreditimit për fondet IPARD, si dhe do të ketë shkëmbim eksperience të ndërsjelltë për skemat e pagesave direkte, skemat e cilësisë, LPIS, IACS, organizimin e grupeve të prodhuesve, skemat për fatkeqësitë natyrore, skemat për sigurime bujqësore etj;

2.2. Agjencitë gjithashtu do të bashkëpunojnë ngushtë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën në procesin e zhvillimit të strukturave (organigrama, ngritja e kapaciteteve, ndarja e përgjegjësisë, proceset e punës dhe qarkullimit të dokumenteve, etj);

2.3. Shkëmbimi i eksperiencës në proceset integruese të programeve IPARD, akreditimi i masave për PZHR dhe përvoja në fondet IPARD, raportimi etj.;

2.4. Ngritja e nivelit të bashkëpunimit për shkëmbimin e përvojave në zbatimin e programeve për pagesa direkte;

2.5. Shkëmbimi i njohurive rreth zbatimit të procedurave (miratimit/aprovimit, autorizimit, kontrollit në terren, sistemit IT, kontrollit të brendshëm, parregullsitë, raportimet, ekzekutimit të pagesave etj).

Neni 2 Detyrimet reciproke të palëve

1. Palët nënshkruese, kanë rënë dakord që në zbatim të akteve ligjore kombëtare, procedurave të brendshme të zbatueshme nga palët, të ofrojnë bashkëpunimin e ndërsjellë në proceset e përcaktuara në nenin 1, të kësaj marrëveshje bashkëpunimi si dhe të angazhohen maksimalisht në kryerjen me rigozitet të tyre.

2. Të dyja agjencitë do të bashkëpunojnë në sektorët e përcaktuar në nenin 1 të kësaj marrëveshje bashkëpunimi duke përdorur mjete dhe metoda të ndryshme, si:

2.1. Shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës në zhvillimin e sistemeve të zbatimit operacional për përdorimin e fondeve të BE-së të para-anëtarësimit (IPARD) si dhe për pagesat direkte, sistemin e identifikimit të parcelave të tokës (LPIS) etj.

2.2. Organizimi i përbashkët i takimeve, konferencave, tryezave të rrumbullakëta dhe seminareve, me pjesëmarrjen e ekspertëve dhe punonjësve të të dyja agjencive.

2.3. Trajnime përmes organizimit të seminareve për menaxhimin e fondeve dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin rural dhe politikat e pagesave direkte, si dhe përmes angazhimit të ekspertëve nga të dyja agjencitë;

2.4. Shkëmbimi i punonjësve (trajnime në punë) në departamente/ sektorë të ndryshëm të të dyja agjencive.

2.5. Shkëmbim dhe/ose trajnime dhe konsultime (që zgjasin deri në pesë (5) ditë) pune nga ekspertë të agjencive, në fusha me interes të përbashkët, duke pasur parasysh disponueshmërinë e burimeve të të dyja agjencive.

3. Palët bien dakord të veprojnë brenda 10 ditëve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, duke caktuar personat përgjegjës për komunikimin dhe bashkëpunimin për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe t'ua komunikojnë informacionin me shkrim personave të emëruar nga pala tjetër.

4. Organizimi i aktiviteteve të lartpërmendura do të dakordësohet paraprakisht ndërmjet personave të kontaktit të të dyja agjencive përmes postës elektronike, bisedave telefonike ose takimeve, në një periudhë të arsyeshme kohore për të mundësuar një organizim të suksesshëm.

5. Personat e caktuar në paragrafin 3 të këtij neni, duhet të jenë të pranishëm në takimet e përbashkëta dhe të raportojnë për çdo çështje në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Burimet e financimit

1. Të dyja Agjencitë do të ndërmarrin hapat e nevojshëm në mënyrë që të sigurojnë mjetet e nevojshme financiare nga buxheti i tyre kombëtar ose të marrin mbështetje financiare nga burime ndërkombëtare për realizimin e bashkëpunimit nga kjo Marrëveshje.

2. Në të gjitha aktivitetet e ndërsjella/të përbashkëta dhe në aktivitetet që kanë të bëjnë me shkëmbimin e njohurive, përvojës dhe ekspertëve, secila agjenci do të mbulojë shpenzimet (kostot e transportit, shpenzimet ditore dhe shpenzimet e akomodimit) për stafin e saj.

Neni 4

Konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit

1. Palët do të përdorin informacionin e marrë në lidhje me këtë Marrëveshje ekskluzivisht për qëllime të zbatimit të programeve mbështetëse në bujqësi, duke e mbajtur këtë informacion në përputhje me rregulloret që përcaktojnë fushën e mbrojtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale dhe zyrtare.

2. Palët që posedojnë të dhënat e marra në përputhje me këtë Marrëveshje do të trajtojnë informacionin e marrë në mënyrë konfidenciale, pa e ndarë informacionin me persona të paautorizuar, si dhe do të nënshkruajnë një deklaratë të veçantë për paanshmërinë dhe konfidencialitetin.


Neni 5 Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët.
2. Marrëveshja lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar deri kur njëra palë njofton palën tjetër nëpërmjet rrugëve diplomatike për përfundimin e saj.
3. Kjo marrëveshje bashkëpunimi mund të ndryshohet me miratimin reciprok me shkrim të Palëve në çdo kohë. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me të njëjtën procedurë ligjore të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.
4. Për zbatimin e kësaj Marrëveshje ngarkohen, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës dhe Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural institucion varësie i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë.
5. Palët kanë rënë dakord të kërkojnë zgjidhje miqësore për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, në takimet e përbashkëta të përfaqësuesve të tyre.

Nënshkruar në Prishtinë, më 20. 06 2022 në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe.


Për Ministrinë e Bujqësisë,
Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
së Republikës së Kosovës

FATON PEÇI


Nënshkrimi

Për Ministrinë e Bujqësisë dhe
Zhvillimit Rural të Republikës
së Shqipërisë

FRIDA KRIFCA


Nënshkrimi